

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Nr. 43 /2025

Dt. 12 /02 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 27 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në bazë të nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshim dhe plotësimin e Vendimit Nr.115/2024, të datës 10.05.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin 286/2024, të datës 30.07.2024.**

1.Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1 e Vendimit Nr.115/2024, i datës 10.05.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.286/2024, të datës 30.07.2024 për emërimin e anëtarëve të Panelit për Adoptim, si në vijim:


“1.1.Blerim Shabani, Drejtor i Departamentit për Politikat e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryesues.”

2. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



*Vendimi i'u dërgohet:*

- Z. Blerim Shabani;
- Anëtarëve të Panelit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice  
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 115 /2024

Dt. 10/05/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 27 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në bazë të nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në bazë të propozimeve të përfaqësuesve nga Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale dhe propozimeve nga KOMF, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Paneli për Adoptim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me këtë përbërje:
  - 1.1. Ruzhdi Osmani, Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Politikave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryesues,
  - 1.2. Magbule Koci, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, anëtare,
  - 1.3. Nafije Selimi, zyrtare e lartë për sanimin e marrëdhënieve familjare dhe kontaktim, anëtare,
  - 1.4. Agim Mala, udhëheqës i shërbimit në QPS Pejë, anëtar,
  - 1.5. Burim Behluli, Drejtor i Programit në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, anëtar.

2. Mandati i anëtarëve të Panelit për Adoptim zgjatë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Obligohet Paneli që detyrat dhe përgjegjësitë t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Me këtë vendim, shfuqizohet vendimi nr. 138/2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin nr. 176/2023 i datës 04.09.2023.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m


Bazuar në ndryshimet ligjore me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare është ndryshuar edhe përbërja e Panelit për Adoptim konform nenit 27 (paragrafi 7) të këtij Ligji me tre (3) anëtarë nga Departamenti përkatës dhe sipas propozimeve të pranuar nga një (1) përfaqësues i QPS dhe një (1) përfaqësues të OJQ, është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi iu dërgohet :

- Kabinetit të Ministres së MD-së;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të MD-së;
- Anëtarëve të Panelit për Adoptim;
- DPSHSMF/MD; dhe
- Arkivit të MD-së.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

**Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice**

Nr. 286 /2024

Dt. 30/07 /2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 27 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në bazë të propozimit nga Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale, si dhe propozimit nga Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.4 dhe 1.5 e Vendimit nr. 115/2024, të datës 10.05.2024 për emërimin e anëtarëve të Panelit për Adoptim, si në vijim:
  - 1.1 Kimete Kryeziu, Udhëheqëse e Shërbimeve Sociale në QPS Kamenicë, anëtare;
  - 1.2 Remzije Krasniqi, Drejtor për Avokim në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, anëtare.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albulena HAXHIU**  
  
**Ministre e Drejtësisë**

Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të MD-së;
- Anëtarëve të Panelit;
- DShSMF/MD;
- Arkivit të MD-së.